



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL  
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 04.08.2022

## NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, në Urdhrin e Kryeministrit nr. 81, datë 10.05.2022, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuar si mëposhtë vijon :

### I. NËPUNËS INFORMACIONI NË AZHBR QENDËR (me kontratë pune 8h/ditë), kategoria III

**Detyrat kryesore:** Ofron shërbim në reception dhe/ose në media sociale, numrin jeshil duke respektuar rregullat e etikes dhe komunikimit me qytetarët / fermerët. Informon dhe promovon programet e skemave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

### Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

- Të kenë mbaruar arsimin e lartë universitar, niveli Bachelor. (Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi);
- Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese;
- Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit;
- Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në;
- Të kenë përvojë pune ose internshipi/ praktika profesional;

### Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 37/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të

BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II).

- Njohuritë mbi Marrëveshjen Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së, për Shqipërinë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD).
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", i ndryshuar.

**Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 08.08.2022, ora 16:30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikon; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.**

**TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:**

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

**Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al).**

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**